

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Moti i keq godet Spanjën, një viktimë në Katalonjë! Paralajmërimet dhe kaos në transport (VIDEO) - Euro news Albania                                                                                                                          |
| ADRESA  | <a href="https://euronews.al/moti-i-keq-godet-spanjen-nje-viktme-ne-katalonje-paralajmerime-dhe-kaos-ne-transport-video/">https://euronews.al/moti-i-keq-godet-spanjen-nje-viktme-ne-katalonje-paralajmerime-dhe-kaos-ne-transport-video/</a> |
| BURIMI  | euronews.al                                                                                                                                                                                                                                   |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                        |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 17 shtator 2026, 06:21:07 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 06:20:37 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 394f742cee7c3f9f8ee173ee68b912321c8de5cfca797dfad862b47c39b3ed0d |
| TEKSTI     | 3ea9c3f3ab4146fdae5104273bdd894625f1d3ac1758e62fd9ca50a1be44356c |
| PAMJA      | 41c1c9f98fb9c5d6d7e085e20d665228f0b8651316185375b7efa2ea7b748852 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|                |                                                                                                 |
|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE      | d0eacfeee18d0e8f82d4d7d94282ac93f75772c43740391f24a7962a7189a03a                                |
| E MËPARSHMJA   | —                                                                                               |
| RRËNJJA MERKLE | 7552192d4562aa207666eadcaed525346db194fc39c694c2be0ac3ebbafe5dc8                                |
| ANKORIMI       | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahason hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d0eacfeee18d0e8f82d4d7d94282ac93f75772c43740391f24a7962a7189a03a>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



## TREND

Gjyqi i UÇK Inteligjenca Artificiale Donald Trump Integrimi ne BE Protesta në Tiranë

BOTA

## Moti i keq godet Spanjën, një viktimë në Katalonjë! Paralajmërime dhe kaos në transport (VIDEO)



17 Shtator 2026 | 08:20

Një burrë humbi jetën si pasojë e motit të keq që ka goditur bregdetin mesdhetar të Spanjës, duke shkaktuar përmblytje dhe probleme serioze në qarkullim.

Trupi i pajetë i tij u gjet të enjten në orët e para të mëngjesit në Olivella, rreth 40 kilometra në perëndim të Barcelonës. Sipas shërbimeve të emergjencës, burri po drejtonte një makinë, e cila u mor përpara nga ujërat e rrëmbyeshme të një përroi.

Zjarrfikësit e gjetën trupin rreth 500 metra larg vendit ku ishte gjetur automjeti, ndërsa policia e Barcelonës konfirmoi se bëhej fjalë për drejtuesin e mjetit.

### Alarm i kuq në Barcelonë

Shërbimi meteorologjik spanjoll AEMET kishte vendosur për një periudhë zonat bregdetare të Barcelonës nën alarm të kuq, duke paralajmëruar për reshje të dendura dhe rrezik të lartë për përmblytje të menjëhershme.

Autoritetet u bënë thirrje banorëve në Katalonjë dhe Valencia që të kufizonin lëvizjet vetëm për rastet absolutisht të nevojshme dhe të ndiqnin udhëzimet e shërbimeve të Mbrojtjes Civile.

Kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, në një postim në X, i përshkroi situatat si "veçanërisht të ndërlikuar", duke u kërkuar qytetarëve të tregoheshin jashtëzakonisht të kujdesshëm.

Moti i keq shkaktoi probleme të mëdha edhe në Barcelonë. Disa stacione metroje u mbyllën, linjat e autobusëve ndryshuan itineraret për shkak të rrugëve të përmblytura, ndërsa probleme u raportuan edhe në rrjetin hekurudhor periferik.

Vonesa dhe anulime u shënuan gjithashtu në aeroportin e Barcelonës, i dyti më i madh në Spanjë për nga numri i pasagjerëve.

Shërbimet e emergjencës në Katalonjë morën më shumë se 850 telefonata të lidhura me motin e keq, ndërsa u thirrën për të ndërhyrë në mbi 500 incidente.

### Reshje të dendura edhe në Valencia

Moti i keq shkaktoi probleme të konsiderueshme edhe në Valencia, një rajon që ende i ka

### LAJMI I FUNDIT

08:19 Rachida Dati në gjykatë, ish-ministrja franceze në gjyq për çështjen e korrupsionit Renault-Nissan

08:11 5 interpelanca sot në Kuvend, protestë jashtë Parlamentit

08:10 Trump: Irani kontaktoi drejtpërdrejt SHBA-në, dëshiron të arrijë një marrëveshje

SHËRNDARJE Brenda propozimit të von der ARTIKULLIN Leyen për një arkitekturë të re të sigurisë së BE-së

07:22 BE rikonfirmon angazhimin për zgjerim, Kos: Një union më i madh do të jetë një union më i fortë

07:11 Trump kërcënon BE-në me ulje të tregtisë për shkak të propozimit "armiqësor" për ta bërë Kanadanë anëtare të asociuar

TESTIM

te rresketa kujtimit e permbytjeve katastrohke te vitit 2024, ku humben jeten me shume se 230 persona.

Në disa zona u regjistruan rreth 70 milimetra shi brenda vetëm 30 minutash. Shërbimet e emergjencës raportuan 478 incidente në provincë, shumica e të cilave kishin të bënin me dëme materiale, banesa të përmbytura dhe probleme në qarkullim.

Në qytetin e Valencias u pezullua funksionimi i të gjitha linjave të metrosë, ndërsa aeroporti qëndroi i mbyllur për disa orë. Sipas kompanisë menaxhuese AENA, gjithsej 12 fluturime u detyruan të devijonin drejt aeroporteve të tjera.

Stuhitë e fuqishme erdhën pas një shtatori jashtëzakonisht të thatë dhe një vere me temperatura rekord në Spanjë.

Shkencëtarët theksojnë se ndryshimet klimatike të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor po rrisin intensitetin e stuhive në Mesdhe. Këto fenomene shfaqen tradicionalisht në lindje të Spanjës gjatë muajve të vjeshtës.

📍 Sant Andreu (Barcelona)  
Y la alerta llega 1h después de que todo esté inundado [pic.twitter.com/0rP8rvKg0x](https://pic.twitter.com/0rP8rvKg0x)  
— Biel Ibañez (@bielibanezz) September 16, 2026

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

BOTA  
**Trump: Irani kontaktoi drejtpërdrejt SHBA-në, dëshiron të arrijë një marrëveshje**  
Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, tha të mërkurën se Irani i është drejtuar drejtpërdrejt Uashingtonit dhe dëshiron të arrijë një marrëveshje, ndërsa e përshkroi gjendjen...  
08:10 | 17/09/2026

BOTA | LAJM KRYESOR  
**Trump kërcënon BE-në me ulje të tregtisë për shkak të propozimit “armiqësor” për ta bërë Kanadanë anëtare të asociuar**  
Shefja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, hodhi idenë e anëtarësimit të asociuar për Otavën gjatë fjalimit të saj vjetor për Gjendjen e Unionit...  
07:11 | 17/09/2026

BOTA | TEKNOLOGJI  
**Lexuesit po kalojnë te përmbledhjet e AI, “Mirror” shkurton 220 vende pune**  
Reach, kompania që zotëron gazetat Mirror dhe Express në Angli do të shkurtojë edhe 220 vende pune në redaksitë e saj, ndërsa përballet me një...  
05:40 | 17/09/2026

| TEMA   | SHËRBIME                           | KOMPANIA             |
|--------|------------------------------------|----------------------|
| Vendi  | Live                               | Rreth Euronews       |
| Rajoni | Lajmi fundit                       | Kushtet e përdorimit |
| Bota   | Na ndiqni                          | Politika e cookie    |
| Vídeo  | Euronews Radio                     | Kontakttoni          |
|        | Për persona me aftësi të kufizuara | Punësimi             |

Follow Euronews on all platforms:

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.